



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ DATË ____/____/2025

PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE DHE DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 35, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. ISMAIL SPAHO DHE Z. EDMOND SPAHO, NR. 35, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET ZNJ. MANJOLA SEFERI, NR. 72, DATE 20.07.2020 PËRSA I PERKET Z. SALI KURTI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, "Për mbrotjen civile", Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 25.06.2020 "Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i Njesisë Administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga Programet e Rindërtimit", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 03.02.2023 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative Sukth, rruga "Ismet Nanushi", pallati nr. 12/2 i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 09.05.2022 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative nr. 4, rruga "Aleksandër Goga", pallati nr. 344, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë "Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5", i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, kryetari i

Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë dhe miratojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe

TË VENDOSË:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 03.02.2023 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Ismail Spaho dhe Edmond Spaho në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 1+1 në 2+1 në Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Manëz, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 09.05.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të znj. Manjola Seferi në masën e strukturës së njësisë së banimit 1+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Sali Kurti në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 2+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

ZËVENDËSKRYETAR

Elio Jani

ZËVENDËSKRYETAR

Renis Mullaj

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtore

Ardian Djaxaj

KRYETAR

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DS4-DS5

RELACION

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 35, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. ISMAIL SPAHO DHE Z. EDMOND SPAHO, NR. 35, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET ZNJ. MANJOLA SEFERI, NR. 72, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. SALI KURTI

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 25.06.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i Njësisë Administrative si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfituar nga Programet e Rindërtimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, rruga “Ismet Nanushi”, pallati nr. 12/2 i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 4, rruga “Aleksandër Goga”, pallati nr. 344, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” si dhe Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk

janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5” i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 mori në shqyrtim ankesat e mëposhtme:

1. Z. Edmond Spaho banues në Njësine Administrative Sukth, Durrës.

Z. Edmond Spaho me nr. ID I30531068L nuk është shpallur përfitues me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës me ankesën nr. 8122 prot., datë 01.07.2024 duke kërkuar të trajtohet nga procesi i rindërtimit me një banesë të re ose me sipërfaqe shtesë me pretendimin se familja e tij me përbërje 4 persona ka banuar në të njëjtin apartament banimi me dy prindërit të cilët kanë përfituar njësine e banimit me strukturë 1+1 me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Në shqyrtimin e ankesës Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 vëren se aplikimi është bërë nga z. Ismail Spaho sipas kërkesës me nr. 8 prot., datë 05.02.2020, e cila është regjistruar me nr. 5640 në regjistrin elektronik të të dhënave. Në dosjen e aplikantit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me nr. 8122/2 prot., datë 17.09.2024 me kërkesë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, ndodhen këto dokumenta:

Fotokopje e kartës së Identitetit të z. Edmond Spaho.

Certifikatë familjare me përbërje 2 persona (Ismail Spaho dhe Gurgazie Spaho), lëshuar me datë 05.07.2022.

Akt Konstatim.

Akt-Ekspertizë e thelluar.

Kontratë shit-blerje.

Vërtetim nga Njësia Administrative Sukth që vërteton se z. Ismail Spaho ka patur një banesë në datën 26.11.2019 në pallatin e shembur në mënyrë të programuar me Vendim të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Durrës, lëshuar me datë 07.02.2022.

Fotokopje e librezës së CEZ shpërndarje me nr. Kontrate 57682, në emër të z. Ismail Spaho.

Fotokopje e librezës së UKD me nr. Kontrate 7002090, në emër të z. Ismail Spaho.

Më pas me anë të ankesës pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 janë dërguar:

Vërtetim për Fakte dhe të Dhëna nga Njësia Administrative Sukth që vërteton se familja e z. Ismail Spaho me përbërje familjare 2 persona (Ismail Spaho dhe Gurgazie Spaho) si dhe familja e z. Edmond Spaho me përbërje familjare 4 persona (Edmond Spaho, Elsa Spaho, Emin Spaho, Abdullah Spaho) janë banorë të kësaj Njësie Administrative, në fshatin Kullë dhe me vendbanim deri me 26.11.2019, lëshuar me nr. 317/2 prot., datë 28.06.2024.

Certifikatë familjare me përbërje 2 persona (Ismail Spaho dhe Gurgazie Spaho), lëshuar me datë 28.06.2024.

Certifikatë familjare me përbërje 4 persona (Edmond Spaho, Elsa Spaho, Emin Spaho dhe Abdullah Spaho), lëshuar me datë 28.06.2024.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në trajtimin e ankesës vëren se strukturat e ngritura në kuadër të Rindërtimit pra Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit në trajtimin e rastit në fjalë kanë arsyetuar duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” dhe duke evidentuar faktin (nga strukturat përkatëse) të përbërjes familjare (2 persona) kanë klasifikuar familjen e z. Ismail Spaho përfitues të njësisë së banimit me strukturë 1+1, evidentuar kjo me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 35, datë 03.02.2023 dhe me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 06.03.2024 ka dalë përfitues për transferim në zonën e Manzës. Por referuar Vërtetimit të Faktit nga Njësia Administrative Sukth me nr. 317/2 prot., datë 28.06.2024 që vërteton se familja e z. Ismail Spaho me përbërje familjare 2 persona dhe familja e z. Edmond Spaho me përbërje familjare 4 persona janë banorë të kësaj Njësie Administrative, në fshatin Kullë dhe me vendbanim deri me date 26.11.2019 në objektin e përbashkët me të dhëna (Shtëpi banimi me nr. Kate 5, pallat; Nr. Objekti 9; Rruga “Ismet Nanushi”, ZK. 2321; Viti i ndërtimit të banesës: para vitit 1993, me nr. kontrate të energjisë elektrike 57682 dhe nr. Kontrate të ujësjellës kanalizimeve 7002090) ky Komision konstaton se z. Ismail Spaho dhe z. Edmond Spaho kanë jetuar në të njëjtën banesë pavarësisht faktit se ndodhen të ndarë në certifikatë familjare.

Në këtë rast Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur konstaton se kjo do të ishte në kundërshtim jo vetëm me VKM-në nr. 301 datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit” por edhe me nenet 6 dhe 8 të Aktit Normativ sipas së cilëve: *Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe shëndetit. Rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ka si qëllim, për aq sa është e mundur, garantimin e kthimit në kushte optimale jetese dhe funksionimi të komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, si dhe forcimin e aftësisë së këtyre komuniteteve për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen. Autoritetet publike dhe subjektet private përgjatë procesit të rindërtimit janë të detyruara të garantojnë përdorimin e kushteve dhe teknikave që parandalojnë rreziqet e fatkeqësive natyrore në të ardhmen në përputhje me konceptin “rindërto më mirë”.*

“Strehimi i përshtatshëm për një individ ose familje konsiderohet strehimi që garanton privatësi, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) Hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi; b) Shërbimet bazë, Brenda mjedisit të banimit; c) Qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë.”

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4 – DS5 referuar dokumentacionit që disponon, akteve ligjore të sipërcituara, legjislacionit në fuqi si dhe Vërtetimit të Faktit nga Njësia Administrative Sukth, propozon që praktika t'i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës për shqyrtimin e propozimit të këtij Komisioni lidhur me ndryshimin e Vendimit të Këshillit

Bashkiak nr. 35, datë 03.02.2023 që lidhet me përfshirjen e z. Ismail Spaho dhe Edmond Spaho në listën e përfituesve në masën e strukturës së njësishë së banimit nga 1+1 në 2+1 në Zonën e Re për Zhvillim, Njësia Administrative Manëz.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

2. Znj. Manjola Seferi banuese në lagjen nr. 15, Rruga “Aleksandër Goga”, Durrës.

Znj. Manjola Seferi me nr. ID H85223064N i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës me ankesën nr. 9674 prot., datë 20.08.2024 duke kërkuar të trajtohet nga procesi i rindërtimit për banesën në të cilën jeton prej 20 vitesh por që për efekt procedurash nuk e ka kaluar në pronësi.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në shqyrtimin e ankesës vëren: Subjekti Manjola Seferi nuk ka bërë aplikim në portalin “Shtëpia Imë”, aplikimi është bërë nga File Seferi dhe Marsina Seferi. Në dosjen e aplikantit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me kërkesë të Komisionit ndodhen këto dokumenta:

Vërtetim nga Dokumenti Hipotekor që vërteton se në regjistrimin hipotekor me nr. 16, datë 17.01.2001 figuron e regjistruar në pronësi të Sami Seferi pasuria me nr. 22/87 e ndodhur në ZK 8511 me sip. 58.79 m², lloji apartament me strukturë 1+1, lëshuar me datë 16.02.2001. Shoqëruar me Hatën Treguese të Regjistrimit. Certifikatë familjare me përbërje 32 persona (File Seferi dhe Marsina Seferi), lëshuar me datë 10.02.2020.

Akt Konstatim, datë 16.12.2019.

Fotokopje e kartës së Identitetit të znj. File Seferi.

Në vijim janë depozituar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5:

Fotokopje e librezës së OSHEE me nr. kontrate A-22863.

Fotokopje e librezës së UKD me nr. kontrate 1094260.

Fotokopje e kartës së Identitetit të znj. Manjola Seferi.

Vendim për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore me nr. repertori:3921, nr. koleksioni: 2331. Datë 19.09.2024.

Deklaratë Noteriale me nr. repertori: 3955, nr. koleksioni: 2348, datë 23.09.2024.

Certifikatë familjare me përbërje familjare 3 persona (Manjola Seferi, Danila Rama, Cledih Rama), lëshuar me datë 25.10.2024.

Vërtetim nga ASHK që vërteton se znj. Manjola Sami Seferi nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme, lëshuar sipas kërkesës nr. 41801, datë 21.10.2024.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në datën 10.11.2023 i ka dërguar Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike kërkesën e protokolluar me nr. 9546/1 lidhur me arsyen e përjashtimit të ankimuesit nga përfitimi i njësisë së banimit dhe me shkresën nr. 10140/3 prot., datë 17.09.2024 u informuam se nga verifikimet e kryera nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike në lidhje me emrin e znj. Manjola Seferi referuar regjistrin elektronik të aplikimeve nuk rezultoi të ketë kryer aplikim për të përfituar nga dëmet e tërmetit të datës 26.11.2019. Për këtë arsye kjo zyrë nuk ka patur asnjë dokumentacion në lidhje me znj. Manjola Seferi dhe nuk është trajtuar si subjekt.

Lidhur me pretendimin e ankimueses Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në bazë të dokumentacionit të dërguar konstaton se znj. Manjola Seferi rezultoi bashkëpronare e pasurisë me nr. 22/87 e ndodhur në ZK 8511 me sip. 58.79 m², trashëguar nga i ati Sami Seferi, i cili ka ndërruar jetë me datë 07.03.2007 dhe më pas me dëshmi trashëgimie kanë përfituar si trashëgimtare ligjore vajzat Drita Philipp, Diana Seferi, Valbona Gjini, Manjola Seferi, Marinela Çoniku, Marsina Seferi si dhe bashkëshortja File Seferi.

Referuar VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendim i cili klasifikon strukturën e përfituesve të banesës sipas pikës 20.1 dhe tabelës A sipas përbërjes familjare, duke mbajtur në vëmendje edhe Aktin Normativ sipas së cilit neni 21 pika 2 citon: *“Përfitues të njësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësive të banimit të objekteve të shembura, në trojet e të cilave ndërtohen objektet e reja. Struktura e njësisë së banimit që i kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur. Rregulla për trajtimin e mospërputhjeve midis sipërfaqeve dhe strukturës së njësisë së banimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin”*.

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 referuar dokumentacionit që disponon, Aktin Normativ nr. 9 si dhe legjislacionit në fuqi propozon që praktika t’i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës për shqyrtimin e propozimit të këtij Komisioni lidhur me përfshirjen e znj. Manjola Seferi si përfituese të njësisë së banimit me strukturë 1+1.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

3. Z. Sali Kurti banues në Njësinë Administrative Ishëm, Durrës.

Z. Sali Kurti me nr. ID I50524111I është shpallur përfitues me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 dhe me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 28.02.2023 ka kaluar për transferim në zonën e re Spitallë.

Subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës me ankesën nr. 9394 prot., datë 07.08.2024 duke kërkuar të trajtohet nga procesi i rindërtimit me një strukturë banimi më të

madhe me pretendimin se familja e tij përbëhet nga 5 persona të cilët jetojnë në të njëjtën shtëpi banimi.

Në shqyrtimin e ankesës Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 vëren se aplikimi është bërë nga z. Sali Kurti sipas kërkesës me nr. 620 prot., datë 19.02.2020, e cila është regjistruar me nr. 25646 në regjistrin elektronik të të dhënave. Në dosjen e aplikantit të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me nr. 9394/2 prot., datë 07.11.2024 me kërkesë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, ndodhen këto dokumenta:

Certifikatë pronësie me nr. pasurie 40/13, ZK. 2375, Vol. 11, Fq. 206, me sipërfaqe 106 m², në pronësi të z. Jetmir Kurti, lëshuar me datë 11.08.2017. Shoqëruar me Hartën Treguese të Regjistrimit.

Akt Konstatim, datë 27.12.2019.

Vetëdeklarim mbi pasuritë e paluajtshme.

Fotokopje e kartës së Identitetit të z. Sali Kurti.

Fotokopje e kartës së Identitetit të z. Jetmir Kurti.

Certifikatë familjare me përbërje 4 persona.

Fotokopje e librezës së OSHEE me numër kontrate AL0026187, në emër të z. Jetmir Kurti.

Fotokopje e librezës së UKD me numër kontrate 7038141, në emër të z. Jetmir Kurti.

Leje Legalizimi.

Akt Ekspertizë e Thelluar.

Më pas janë dërguar pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5:

Vërtetim nga Njësia Administrative Ishëm, i lëshuar me datë 04.11.2020, që vërteton se znj. Gjyle Kurti me nr. ID C75420028C me datë 26 nëntor 2019, datë në të cilën ka rënë tërmeti jetonte në të njëjtën banesë me z. Sali Kurti. Banesa ndodhet në fshatin Lalëz me nr. pas 29/1, ZK 2375 dhe është shpallur e pabanueshme me ekspertizë të thelluar nga instituti i ndërtimit me shkallë dëmi DS5.

Certifikatë familjare me përbërje 5 persona (Sali Kurti, Jonida Kurti, Reina Kurti, Jetmir Kurti, Rejon Kurti), lëshuar me datë 06.08.2024.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 në trajtimin e ankesës vëren se strukturat e ngritura në kuadër të Rindërtimit pra Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit në trajtimin e rastit në fjalë kanë arsyetuar duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” dhe duke evidentuar faktin (nga strukturat përkatëse) të përbërjes familjare (4 persona) kanë klasifikuar familjen e z. Sali Kurti përfitues të njësisë së banimit me strukturë 2+1, evidentuar kjo me Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 72, datë 20.07.2020 dhe me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 53, datë 28.02.2023 ka kaluar për transferim në zonën e re Spitallë.

Por referuar Vërtetimit të Faktit nga Njësia Administrative Ishëm lëshuar me datë 04.11.2020 që vërteton se znj. Gjyle Kurti me datë 26 nëntor 2019 ka jetuar në të njëjtën banesë me z. Sali Kurti, ky Komision konstaton se znj. Gjyle Kurti dhe z. Sali Kurti kanë jetuar në të njëjtën banesë (5 persona) pavarësisht faktit se ndodhen të ndarë në certifikatë familjare.

Në këtë rast Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur konstaton se kjo do të ishte në kundërshtim jo vetëm me VKM-në nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit" por edhe me nenet 6 dhe 8 të Aktit Normativ sipas së cilëve: *Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe shëndetit. Rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ka si qëllim, për aq sa është e mundur, garantimin e kthimit në kushte optimale jetese dhe funksionimi të komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, si dhe forcimin e aftësisë së këtyre komuniteteve për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen. Autoritetet publike dhe subjektet private përgjatë procesit të rindërtimit janë të detyruara të garantojnë përdorimin e kushteve dhe teknikave që parandalojnë rreziqet e fatkeqësive natyrore në të ardhmen në përputhje me konceptin "rindërto më mirë".*

"Strehimi i përshtatshëm për një individ ose familje konsiderohet strehimi që garanton privatësi, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) Hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi; b) Shërbimet bazë, Brenda mjedisit të banimit; c) Qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë."

Sa më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4 – DS5 referuar dokumentacionit që disponon, akteve ligjore të sipërcituara, legjislacionit në fuqi si dhe Vërtetimit të Faktit nga Njësia Administrative Ishëm, propozon që praktika t'i kalohet Këshillit Bashkiak Durrës për shqyrtimin e propozimit të këtij Komisioni lidhur me ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 20.07.2020 që lidhet me përfshirjen e z. Sali Kurti në listën e përfituesve në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 2+1 në 3+1.

Sa më sipër sqarojmë se kundër këtij vendimi mund të ankimohet në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE DS4-DS5

ELIO JANI

ARDJAN ILIJAZAJ

RENIS MULLAJ